



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MJEDISIT

Nr. 6294 Prot.

Tirane, me 27.9 2016

DEKLARATE MJEDISORE

per Vleresimin Strategjik Mjedisor

Ne mbështetje të Ligjit Nr. 91, datë 28.02.2013 "Për vleresimin strategjik mjedisor" dhe akteve nenligjore që rrjedhin prej tij, Ministri i Mjedisit, leshon këtë Deklaratë Mjedisore për:

Projekti: Plani i Përgjithshëm Vendor për bashkinë Krujë

Kerkuesi: Bashkia Krujë

Kufijte e zones që mbulon plani: e gjithë sipërfaqja e bashkisë Krujë së bashku me njësitet e saj administrative

Përdorimi i deklaratës mjedisore

Deklarata Mjedisore nuk përjashton detyrimin që për projekte të vecanta të parashikuara në këtë Plan t'i nënshtrohen kërkesave të legjislacionit në fuqi për vleresimin e ndikimit në mjedis, për lejet e mjedisit dhe akteve të tjera normative në fuqi.

Qëndrimi i Ministrisë:

Plani i propozuar në parim përputhet me objektivat e mbrojtjes së mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

Duke realizuar nderhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Përfshirja efektive e grupeve perkatese të interesit ka kontribuar në cilësinë e vleresimit, ka sjellë të dhëna për analizën dhe raportin e VSM-së dhe do të mbështesë zbatimin e planit pas miratimit të tij, si dhe do të kontribuojë në një pranim më të lehtë dhe më të zbutur të projekteve perkatese.

Ndikimet e mundshme në mjedis të planit

Gjatë zbatimit të projekteve/veprimeve, priten të ndodhin impakte pozitive dhe negative. Impaktet pozitive priten për ajrin dhe ndryshimet klimatike si edhe për popullatat dhe asetet materiale. Vlerësimi i rezultateve tregon se nuk do të ketë impakte mbi faktorët klimatike duke konsideruar që mjetet e transportit do të vijojnë të rinovohen në të ardhmen edhe më tej,



gjë që do të sjellë si pasoje permiresim të cilësive të ajrit dhe cilësive të shëndetit human, midis të tjerave. për më tej në pjesën positive të impakteve mbi popullatën dhe asetet materiale do të vijë si rezultat i zbatimit të infrastruktures në përgjithësi që do të bëjë të mundur pakesimin e kohës së udhëtimit, sigurinë në levizje, përafrimin me tregjet dhe qendrat kryesore urbane dhe shërbimet publike në përgjithësi.

Përgjithësisht, shumica e impakteve negative janë të lidhura me fazën e planifikimit (pozicionimi i infrastruktures në hapësirë dhe përgatitja e kushteve teknike të përshtatshme), pasi Shqipëria ka vecori të theksuara diverse dhe të shumta nga ana natyrore, kulturore dhe peisazhi që mund të ndikohen konsiderueshëm prej zhvillimeve të infrastruktures, sidomos atyre me shtrirje të gjera dhe korridoreve sipas sektoreve (transport, energji, ujë, etj.). Impaktet negative shfaqen në fazën e planifikimit prej aspekteve të përdorimit të tokës, efekteve në ujë, natyrë (si biodiversiteti edhe zonat me status të mbrojtur), trashëgimie kulturore dhe peisazhin. Këto impakte do të kërkojnë krijimin e një programi bashkëkohor mbi masat zbutëse dhe një zbatim të përshtatshëm të këtyre masave. Impakte negative mbi shëndetin human mund të ndodhin për shkak të rritjes së ndotjes nga zhurmat dhe impaktet në cilësinë e ajrit, veçanërisht në zonat me densitet të lartë banimi ku do të përqendrohen edhe një seri veprimesh në territor të ngushtë dhe kjo do të ndikojë kryesisht në fazën e zbatimit të projekteve specifike.

Vlerësimi i përputhshmërisë së objektivave:

Në përgjithësi, në këndvështrimin e përputhshmërisë me objektivat mjedisore, objektivat dhe politikat e Planit, janë si më poshtë:

- objektivat përputhen plotësisht (4 objektiva)
- objektivat përputhen pjesërisht (3 objektiva)
- lidhja mes objektivave është e zbehtë (3 objektiva)

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një rërkifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore.

Konkretisht:

Në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore, vërehet një diversifikim i përputhshmërisë sipas fushave përkatëse mjedisore.

Konkretisht:

- Secila prej objektivave të Planit (përveç 2 objektivave të sistemit Bujqësor) është në përputhshmëri të plotë me të paktën 3 objektiva mjedisore;
- Pesë objektiva të planit kanë një lidhje të pjesshme me të paktën një objektive mjedisore;
- Gjashtë objektiva të planit kanë një lidhje të zbehtë me të paktën 1 objektive mjedisore;
- Dy objektiva të planit që lidhen me sistemin urban dhe turizmin janë në përputhshmëri të plotë me të gjitha objektivat mjedisore;
- Secila prej objektivave të planit (përveç dy objektivave që lidhet me sistemin urban) nuk kanë në lidhje me të paktën 1 objektive mjedisore;

Edhe në këndvështrimin e lidhjes mes objektivave të Planit dhe objektivave mjedisore diversifikimi i përputhshmërisë është i lartë. Sidoqoftë dy objektiva mjedisore (i) OM 1: Garantimi i menaxhimit dhe përdorimit të qëndrueshëm të tokës, dhe (ii) OM 10: Përmirësimi

i kohezionit social, sigurisë së jetesës dhe lëvizshmërisë së qëndrueshme, janë objektivat me nivelin më të lartë të përputhshmërisë me objektivat mjedisore.

Si konkluzion i përgjithshëm mund të thuhet se objektivat dhe politikat e Planit janë në përputhshmeri me objektivat mjedisore.

-Objektivat strategjik të planit ndahen në tre grupe kryesore si më poshtë:

a.Infrastruktura dhe logjistika

Ne këtë grup bëjnë pjesë 13 projekte sipas tabelës bashkelidhur kësaj Deklarate. Projektet e përfshira në këtë grup kanë ndikime të ndryshme në mjedis. Ndikimet në mjedis janë vlerësuar në seksionin nr. 9 për secilin projekt.

b.Turizëm kulturor

Ne këtë grup bëjnë pjesë 7 projekte sipas tabelës bashkelidhur kësaj Deklarate. Projektet e përfshira në këtë grup kanë ndikime të ndryshme në mjedis. Ndikimet në mjedis janë vlerësuar në seksionin nr. 9 për secilin projekt.

c.Inovacion prodhimi

Ne këtë grup bëjnë pjesë 4 projekte sipas tabelës bashkelidhur kësaj Deklarate. Projektet e përfshira në këtë grup kanë ndikime të ndryshme në mjedis. Ndikimet në mjedis janë vlerësuar në seksionin nr. 9 për secilin projekt.

Në përgjithësi, konkludohet se duke realizuar ndërhyrjet e duhura hapësinore dhe duke zbatuar të gjitha masat e nevojshme zbutëse, të gjitha grup-projektet janë të pranueshme nga këndvështrimi mjedisor.

Detajimi i masave për mbrojtjen e mjedisit:

Me qëllimin për të shmangur, minimizuar, kontrolluar dhe menaxhuar ndikimet negative në mjedis të planit në të gjithë fazat e tij duhet të zbatohen me përpikëri të gjitha masat e mëposhtme.

- Të hartohet Programi i Monitorimit Mjedisor gjatë zbatimit të planit, me synim mbledhjen e të dhënave për ndikimet konkrete dhe pasojat në mjedis gjatë zbatimit të tyre, si dhe verifikimin e ndikimeve dhe marrjen e masave zbutëse shtesë, që duhet të zbatohen për të garantuar mbrojtjen e mjedisit. Ky plan të hartohet brenda 6 muajve nga marrja e Deklaratës Mjedisore dhe të merret miratimi i autoriteteve përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.
- Bashkia e Krujës, nën mbikqyrjen e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, që zbaton dhe mbikqyr zbatimin e planit të hartojë një raport vjetor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit, të cilin duhet ta dërgojë pranë Ministrisë së Mjedisit jo më vonë se java e fundit e muajit nëntor.
- Me qëllim lehtësimin e realizimit të programit të monitorimit mjedisor të planit mund të përdoren programe ekzistuese monitorimi, që përputhen me qëllimin e programit të monitorimit mjedisor të planit.
- Projektimi i objekteve të bazohet në parimin e teknologjisë më të mirë të disponueshme, e cila është efiçente në përdorimin e energjisë, si përdorimi i teknologjive izotermike të ndërtimit për çdo objekt të ri po kështu edhe ato të minimizimit të përdorimit të ujit.
- Politikat dhe aktivitetet infrastrukturore të parashikuara në Plan të sigurojnë kohezion, efiçasitet dhe qëndrueshmëri, dhe rritjen e përfitimeve për përdoruesit e kësaj infrastrukture.

- Plani duhet të nxite realizimin e projekteve të impianteve të trajtimit të ujërave të përdorur urbane dhe në një shkallë më të gjërë duke e shtrirë këto masa edhe në aktivitete të tjera industriale që krijojnë shkarkime ujërash industriale të ndotura dhe që ndikojnë sidomos në cilësinë e ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Të projektohet infrastrukture bashkëkohore dhe afatgjatë të kanalizimeve të ujërave të ndotura urbane.
- Të mbrohen vlerat natyrore të zonave në të cilat shtrihet studimi dhe të shmangen në maksimum dëmtimi i sipërfaqeve me vegjetacion natyral.
- Projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me kuadrin ligjor për mbrojtjen e natyrës, duke respektuar shkallën e mbrojtjes së zonës apo nënzonës së mbrojtur ku do të nderhyhet, si dhe statusin e llojeve dhe habitateve që gjenden në zonë, si dhe të komunikohet/bashkëpunohet me AdZM për të marrë masat e domosdoshme për mos cenimin e statusit të këtyre zonave.
- Gjate fazës së projektimit dhe sidomos përpara nisjes së fazës së zbatimit të projekteve/aktiviteteve specifike individuale të Planit duhet të përfshihen masa që do të lehtësojnë ruajtjen e korridoreve të kafshëve migratore. Në rastin kur projektet që do të zbatohen mund të prekin zonën e Mbrojtura apo mund të ndodhen në afërsi të tyre.
- Plani të marrë masa për promovimin e transportit publik të pasagjereve që të kontribuojnë në pakesimin e shkarkimeve në ajër.
- Të zbatohen masa zbutëse për zhvillimin e infrastruktures, gjatë rehabilitimit/ndertimit duhet të parashikohen edhe mbrojtjen nga ndotja e ajrit dhe zhurmat duke aplikuar „best practices“. Në asnjë rast nuk duhet të projektohet brenda, por as në afërsi të territorit të zonave të mbrojtura kur impaktet nga shkarkimet në ajër dhe zhurmat ndikojnë ekosistemet dhe habitatet e llojeve në mbrojtje. Promovimi brenda dhe në periferitë e zonave të mbrojtura duhet të jetë ngritja e infrastrukturave të lehta që mbështesin aktivitetet pa makina, në drejtim të sporteve dhe aktiviteteve në natyrë.
- Hartimi i planeve të menaxhimit të trafikut krahas prioritizimit të zonave të gjelberta publike, duhet të paraprijnë planet urbane të zhvillimit dhe të kenë objektiva të matshme për cilësinë e ajrit.
- Të merren masa për mbrojtjen dhe mos dëmtimin e burimeve ujore që gjenden në zonën në studim.
- Në kuadrin e planifikimit të menaxhimit, vëmendje e veçantë të kushtohet për integrimin e zonave të siguruara nga permbytjet dhe atyre ligatinore, ndërkohë që masat e pyllëzimit të synojnë stabilizimin e humbjeve e tokës nga permbytjet (të zbatohet duke përdorur lloje të bimesisë autoktone që i rezistojnë edhe permbytjeve).
- Për fillimin të zbatimit të projekteve të zgjidhet çështja e administrimit të volumit inert që do të gjenerohet nga operacionet ndërtimore.
- Plani duhet të parashikojë kapacitete më të mëdha për landfillet ekzistuese dhe së pari ndërtimi i landfilleve të reja teknologjike duhet të paraprijë investimet në këto.
- Në teresi, projektet specifike duhet të projektohen në harmoni me standartet e ruajtjes së peisazhit dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, ku së bashku me elementet e cilësisë së mjedisit të jenë përcësore duke aplikuar „best practices“.
- Gjatë implementimit të planit të vihen në zbatim masat zbutëse të propozuara në raportin e VSM-së për minimizimin apo shmangien e ndikimeve negative në mjedis.

Detyrime dhe sanksione:

- › Pavarisht masave dhe rekomandimeve te kesaj Deklarate Mjedisore, gjate zbatimit te planit eshte e detyrueshme te zbatohen kerkesat e legjislacionit mjedisor ne fuqi;
- › Shfaqja e elementeve te rinj ekologjike te panjohur, ne kohen qe kjo Deklarate Mjedisore eshte dhene, sjell si detyrim rivleresimin e saj.
- › Nese plani nuk eshte miratuar brenda 2 viteve nga data e miratimit te deklarates, atehere deklarata behet e pavlefshme dhe procedura e VSM-se fillon nga e para.
- › Ne rast se ministria, strukturat e saj te varesise, njesite e qeverisjes vendore apo edhe grupet e interesuara, perfshi edhe publikun, konstatojne se plani nuk zbatohet ne perputhje me vendimin per miratimin e tyre dhe nuk respektojne kushtet e kerkesat e percaktuara per mbrojtjen e mjedisit, atehere ministria njofton menjehere autoritetin pergjegjes per zbatimin e miratimin e planit dhe, sipas rrethanave, i kerkon sqarimet perkatese apo ndalimin e menjehershem te zbatimit deri ne sqarimin e situates.
- › Nese pasojat ne mjedis e shendet, tejkalojne standardet mjedisore ne fuqi, atehere ministria i kerkon autoritetit miratues e propozues te merren masat e duhura apo te konsiderohet edhe ndryshimi i planit, me qellim qe te permbushen standardet mjedisore.
- › Per mos respektimin e detyrimeve qe rrjedhin nga kjo Deklarate Mjedisore dhe te legjislacionit mjedisor ne fuqi ka sanksione ligjore.

Lefter KOKA



MINISTRI

Lista e projekteve baze:

01	Përmirësimi i rrjeteve teknike
02	Mbrojtje e akuiferëve
03	Pastrimi i lumenjve – mirëmbajtja e sistemit ujq sipërfaqësor
04	Mbrojtje ndaj përmytjeve
05	Menaxhimi i mbetjeve urbane
06	Përmirësimi i rrugës së vjetër kombëtare
07	Përmirësimi i hekurudhës
08	Planifikim i detajuar vendor
09	Plani i emergjencave civile
10	Qendra kulturore në zonat urbane
11	Qyteti mik i fëmijëve

Lista e projekteve të zhvillimit:

PROJEKTE ZHVILLIMI			
Objektivat e Planit	PP	PSV	PSV
	AFAT-SHKURTËR (PROJEKTE PILOT)	AFAT-MESËM	AFAT-GJATË
INFRASTRUKTURË DHE LOGJISTIKË (I+L)	Transformim i stacionit hekurudhor në Budull	Rindërtim i Urës së Tubit	Aksi i ri Thumanë - Tiranë
		Rruga Prezë - Budull	Rruga Krujë-Tiranë
		Lidhja Thumane/Bubq	Sistemi i aeroportit "Nënë Tereza"
		Pol logjistik i integruar në Fushë-Krujë	Lidhja e Bubqit me bregdetin
		Rikualifikim i qendrës urbane të Thumanës	Rruga lidhëse Krujë-Mamurras
		Rikualifikim i qendrës urbane të Fushë-Krujës	Rruga Krujë Burrel
TURIZËM KULTUROR (TK)	Rikuperim i një gureje të braktisura në Krastë	Kalaja e Krujës dhe Pazarit Vjetër	Ujërat termale në Bilaj
	Korridor i gjelbër Albanopolis – Lugina e Ishmit - Bregdet	Pika me interes religjioz dhe panoramik në Sarisallik	Turizëm malor në Qafështamë
	Kalaja e Zgërdheshit (Aibanopolis)		
INOVACION PRODHIMI (IP)	Inkubator ndërmarrjesh dhe shkollë profesionale	Ndërtimi i baxhove eksperimentale	
		Zonë tregu lokal	
		Kontrolli i cilësisë së ajrit dhe shëndetit	